

**VENDIM**  
**Nr. 79, datë 18.12.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nënkreut II, të kreut VI, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 1.2.2017, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në nenin 6, pika 1, shkronja “c”, togfjalëshi “*reputacional dhe ligjor*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*reputacional, ligjor dhe të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*”;
- b) Pas nenit 21, shtohet neni 21/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

**“Neni 21/1**

**Kërkesat mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit**

1. Institucioni mbizotërues harton programe kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel grupi, të cilat duhet të jenë të zbatueshme dhe të përshtatshme për të gjithë subjektet e grupit.

2. Programet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, parashikojnë midis të tjerash:

- a) krijimin e strukturës së nevojshme nga institucioni mbizotërues në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel grupi;
- b) kritere mbi pastërtinë e figurës dhe integritetin e punonjësve, veçanërisht të atyre të përfshirë në procesin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të parashikuara në procedurat e brendshme të punësimit në nivel grupi;
- c) një program vjetor të trajnimit të punonjësve të subjekteve të grupit, lidhur me çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- d) politika dhe procedura për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm, në kuadër të ushtrimit të vigjilencës dhe të administrimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- e) paraqitjen e informacionit mbi klientët, llogaritë dhe transaksionet nga subjektet e grupit të funksioni i përputhshmërisë, i kontrollit të brendshëm dhe/ose i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel grupi, kur ky informacion është i nevojshëm për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- f) masa të mjaftueshme për ruajtjen e konfidencialitetit dhe përdorimin e informacionit të shkëmbyer.”.

2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR  
Gent Sejko